

ANALIZË E

përfshirjes së
sektorit privat në
arsimin profesional
dhe trajnimin dhe
bashkëpunimi me
shkollat



Qershor 2020

ANALIZË E

përfshirjes së
sektorit privat në
arsimin profesional
dhe trajnimin dhe
bashkëpunimi me
shkollat

Qershor 2020



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Projekti është implementuar nga
“HELVETAS”, Maqedonia e Veriut,
Qendra Maqedonase për Edukim
Qytetar dhe Oda Ekonomike e
Maqedonisë

Përpiluar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë për nevojat e Projektit “Edukim për Punësim në Maqedoninë e Veriut “

Autor: mr. Natasha Janevska, këshilltare e pavarur

Lektor: Stanka Damjanovska

Dizajni: KOMA

Dhe grafika: Stevo Serafimov

Kjo analizë është përpiluar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë. Qëndrimet e shprehura në analizën, janë të autorëve dhe nuk është e thënë të përputhen me pikëpamjet dhe politikën e Projektit, organizatave që zbatojnë Projektin dhe donatorin.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave

05

Hyrje

06

Metodologjia

09

Situata
aktuale

11

Gjetjet e
hulumtimit

14

Konkluzione dhe
propozim - masa

27


Shtojca 1:

31

Lista e shkurtesave

RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
APRMV	Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
OEM	Oda Ekonomike e Maqedonisë
KKK	Kuadri Kombëtar i Kualifikimeve
KKV	Klasifikimi Kombëtar i Veprimtarive
KKP	Klasifikimi Kombëtar i Profesioneve
NNjTS	Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat

HYRJE



Qëllimi i dokumentit, me titull aaa Analiza e “Përfshirjes së sektorit privat në arsimin profesional dhe trajnimin dhe bashkëpunimin me shkollat“, është të paraqesë situatën aktuale me zbatimin e trajnimit praktik, interesin e kompanive për përfshirje në proces dhe mbështetjen që ata ofrojnë për shkollat (financiare, materiale, etj.), bazuar në analizën e mendimeve të kompanive të anketuara dhe të sigurohen informacione, çfarë do të ndërmarrin kompanitë pasi të kenë përfunduar nxënësit arsimin e tyre profesional.

Në atë drejtim, Oda Ekonomike e Maqedonisë në kuadër të Projektit “Edukim për Punësim në Maqedoninë e Veriut¹“, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), ndërkaq i implementuar nga “HELVETAS”, Maqedonia e Veriut, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë, në periudhën qershor-korrik të vitit 2020, zhvilloi anketë në terren me anëtarët, mbi situatën aktuale në lidhje me zbatimin e trajnimit praktik dhe interesin e kompanive për përfshirje në proceset.

Në anketën, të realizuar sipas Metodologjisë², u përfshinë gjithsej 70 kompani në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

1 Projekti “Arsim për punësim në Maqedoninë e Veriut” (E4E @ mk) filloi të zbatohet në fillim të muajit mars 2018. Qëllimi kryesor i Projektit është të kontribuojë në punësimin më dinjitoz të të rinjve, veçanërisht grupeve të rrezikuara, në një mënyrë gjithëpërfshirëse sociale dhe të qëndrueshme. Kjo pritet të arrihet përmes një qasje sistemore, e cila do të përpiqet të sigurojë zhvillimin e aftësive profesionale, të cilat janë më të orientuara drejt tregut, përmes arsimit joformal dhe trajnimeve, përmirësimit të bashkëpunimit midis arsimit profesional të mesëm dhe punëdhënësve, veçanërisht në fushën e mësimin praktik të nxënësve si dhe përmes një kornize të përmirësuar ligjore për zhvillimin e aftësive profesionale. Në fazën e tij të parë (2018-2022), në fokus të veçantë të Projektit janë shtatë sektorë (shëndetësia dhe kujdesi social, shërbime personale, hotelieri, agro-sektori, sektori i ushqimit dhe teknologjisë, sektori i makinerisë dhe elektroteknik- TI profili) dhe katër rajone planore në shtet (Juglindor, Jugperëndimor, i Pollogut dhe i Shkupit). Projekti zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, sektorin e biznesit dhe shumë organizata të tjera qeveritare dhe joqeveritare përkatëse.

2 Metodologjia, f.10

nga tetë rajonet planore sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale të Statistikës, nga sektorë të ndryshëm të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe veprimtarive të ndryshme ekonomike, sipas Klasifikimit Kombëtar të Veprimtarive.

Përgjigje në pyetjet e anketës dhanë kompani nga të gjitha rajonet, sipas NNjTS-së: Rajoni i Shkupit, Vardarit, Rajoni Jugperëndimor, Rajoni Juglindor, Rajoni Lindor, Rajoni i Pellagonisë, Rajoni i Pollogut dhe Rajoni planor Verilindor.

Sipas KKK-së, nga gjithsej 16 sektorë të kualifikimeve, u përfshinë 11 sektorë:

1	Gjeologji, xehetari dhe metalurgji;
2	Ndërtimtari dhe gjeodezi;
3	Ekonomi, drejtësi dhe tregti;
4	Elektroteknikë (TIK);
5	Bujqësi, peshkatari dhe veterinari;
6	Shërbime personale;
7	Makineri;
8	Komunikacion, transport dhe depozitim;
9	Tekstil, lëkure dhe prodhime të ngjashme;
10	Hoteleri dhe turizëm;
11	Kimi dhe teknologji.

Sipas KKV-së, nga gjithsej 21 sektorë të veprimtarive, në anketëhulumtuese përgjigje është siguruar nga 15 sektorë të veprimtarive:

1	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari;
2	Xehetari dhe gurore;
3	Industria prodhuese;
4	Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar;
5	Furnizim me ujë; shkarkimi i ujërave të zeza, menaxhim me mbeturinat dhe veprimtari për rehabilitimin e mjedisit;
6	Ndërtimtari;
7	Tregti me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave;
8	Transport dhe depozitim;
9	Objektet e akomodimit dhe veprimtari shërbimi me ushqim;
10	Veprimtari financiare dhe të sigurim;
11	Informacione dhe komunikime;
12	Veprimtari në lidhje me pronën e patundshme;
13	Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike;
14	Veprimtari administrative dhe ndihmëse shërbyese dhe
15	Veprimtari të tjera shërbimi.

Këto parametra plotësojnë aspektin përfaqësues, në lidhje me nxjerrjen e konkluzioneve të duhura nga hulumtimi.

Rezultatet nga anketa hulumtuese paraqesin bazë për dialog të mëtutjeshëm ndërmjet palëve të interesuara të përfshira në arsimin profesional dhe trajnimin për të krijuar partneritete të gjera dhe për të përmirësuar bashkëpunimin midis kompanive dhe shkollave, si dhe për të ndjekur tendencat në ekonomi dhe teknologji dhe për të harmonizuar kualifikimet arsimore sipas kërkesave të sektorit privat.

METODOLOGJIA



Qëllimi kryesor i analizës me titull “Përfshirja e sektorit privat në arsimin profesional dhe trajnimin dhe bashkëpunimi me shkollat” ishte përmes një qasje kërkimore për të identifikuar situatën aktuale në lidhje me zbatimin e trajnimit praktik, interesin e kompanive për përfshirje në arsimin profesional dhe trajnimin dhe mbështetja që ata u ofrojnë shkollave (financiare, materiale, etj.), si dhe për të siguruar informacione, rreth asaj se çfarë do të ndërmarrin kompanitë me ata nxënës të cilët kanë realizuar trajnim praktik në mjedisin e tyre të punës, pas përfundimit të arsimit profesional. Për nevojat e hulumtimit është përdorur teknika e anketës dhe për atë qëllim është përgatitur një pyetësor.

Pyetësori i anketës përbëhej nga 16 pyetje të hapura dhe të mbyllura, të destinuara për kompanitë. Pyetjet i’u shtruan drejtpërdrejt përfaqësuesve të ekipit menaxhues ose departamentit të burimeve njerëzore. Pyetjet në pyetësorin e anketës u grupuan në dy pjesë:

I PJESA - Informacione të përgjithshme për kompanitë

II PJESA - Përfshirja e sektorit privat në arsimin dhe trajnimin profesional dhe bashkëpunimi me shkollat

Hulumtimi përfshiu 70 ndërmarrje sipas ekzemplarit përfaqësues bazuar në kriteret si më poshtë:

- 1 të përfshihen kompani nga të gjitha rajonet planore në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas NNjTS: *Rajoni i Shkupit, Vardarit, Rajoni Jugperëndimor, Rajoni Juglindor, Rajoni Lindor, Rajoni i Pellagonisë, Rajoni i Pollogut dhe rajoni Verilindor;*
- 2 tu përkasin sektorëve të ndryshëm të kualifikimeve sipas KKK-së;
- 3 tu përkasin aktivitete të ndryshme sipas NKV-së.

Në metodologjinë e hulumtimit u përdorën katër kualifikime: *Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat*³ që siguron ndarje të vetme dhe të unifikuar të njësive territoriale në nivel rajonal dhe në nivel lokal; *Klasifikimi Kombëtar i Veprimtarive*⁴ mbi bazën e të cilit subjektet afariste (persona juridikë dhe fizikë) klasifikohen sipas veprimtarisë që ata kryejnë dhe përmban 21 sektorë, 88 departamente, 272 grupe dhe 615 klasa; *Korniza Kombëtare*

*e Kualifikimeve*⁵ mbi bazën e së cilës kualifikimet ndahen sipas sektorëve dhe niveleve të kualifikimeve dhe siguron bazë për të marrë kualifikime, kalueshmëri dhe cilësi të kualifikimeve dhe përmban 16 sektorë të kualifikimeve dhe *Klasifikimi Kombëtar i Profesioneve*⁶ në bazë të të cilit profesionet janë sistematizuar dhe përfshijnë 10 grupe kryesore, 40 nëngrupe, 124 grupe ndihmëse dhe 433 grupe të vetme.

Në kuadër të hulumtimit u përdor metoda sasiore dhe cilësore. Të dhënat e siguruara nga pyetjet e analizuara janë sistematizuar në një Raport, i cili përmban rekomandime për inkurajimin dhe thellimin e bashkëpunimit të kompanive dhe shkollave profesionale, parashikimin e kualifikimeve sipas nevojave dhe specifikave të kompanive dhe lehtësimin e procedurave dhe kohëzgjatjes së programeve të reja arsimore sipas nevojave të sektori privat.

3 Nomenklatura e njësive territoriale të statistikave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/07, 10/14, 131/19) <http://www.stat.gov.mk/KlasifikaciiNomenklaturi.aspx?id=11> qasur më 2 dhjetor 2019

4 Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve - Rev.2, Vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 147/08) dhe Ligji për sistemin një sportel dhe për mbajtjen e Regjistrimit Tregtar dhe Regjistrimit të subjekteve të tjerë juridikë ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.84/05) <http://www.stat.gov.mk/KlasifikaciiNomenklaturi.aspx?id=2> qasur më 28 korrik 2019 vit

5 Korniza Kombëtare e Kualifikimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.137/2013 dhe 30/2016) <http://mrk.mk/?lang=mk> qasur më 28 korrik 2019 vit

6 Klasifikimi Kombëtar i profesioneve, Vendimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 178/15) <https://av.gov.mk/content/%D0%94%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B8/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%90%D0%92%D0%A0%D0%A1%D0%9C%202019.pdf> qasur më 28 korrik 2019

SITUATA AKTUALE



Jetojmë në një botë dinamike, në të cilën dija dhe inovacioni janë forca shtytëse e zhvillimit ekonomik. Kjo do të thotë që cilësia e arsimit dhe trajnimit është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e vendit, ndërsa politikat për rritjen ekonomike, funksionimin e tregut të punës, uljen e papunësisë dhe balancimin e ofertës dhe kërkesës së punës janë të lidhura ngushtë me politikat e arsimit profesional dhe trajnimit. Nëpërmjet tij, sigurohet kuadër i kualifikuar dhe profesional, ndërsa ekonomitë e suksesshme kanë pikërisht kuadër të tillë, i cili është i aftë të punojë në kompanitë, të kontribuojë në rritjen e produktivitetit gjatë punës dhe të sigurojë avantazh konkurrues në raport me ekonomitë e tjera. Prandaj, arsimi profesional dhe trajnimi, sot janë sfida kryesore dhe reformat më të mëdha po bëhen në atë segment me qëllim njëjti të fitojë cilësi dhe njëkohësisht dimension më të gjerë evropian.

Nga ana tjetër, arsimi profesional dhe trajnimi, përveç aspektit ekonomik, kanë edhe aspekt social dhe lehtësojnë kalimin e nxënësve nga sistemi arsimor në tregun e punës, përkatësisht përmes pajisjes me aftësi profesionale, sigurohet tranzicion i qetë dhe i qëndrueshëm i nxënësve nga shkolla drejt mjedisit të punës. Kjo, gjeneratave të reja u siguron integrimin në shoqëri, gjetjen e vetes në tërësinë shoqërore dhe aftësi për fitim ekonomik.

Parë nga aspekti strukturor, arsimi profesional dhe trajnimi, mund të shihet përmes prizmit të procesit pedagogjik edhe sa i përket vendbanimit. Sipas **procesit pedagogjik**, kjo paraqet ndërthurje e teorisë dhe praktikës / punës praktike dhe për sa i përket **vendi të mësim**, një procesi i mësim

në shkollë për përvetësimin e njohurive profesionale të nxënësve dhe trajnim në një kompani për përvetësimin e aftësive praktike dhe kompetencave, paraqitur në Figurën numër 1. Vendi i mësimin ofron mundësi të ndryshme për përvetësimin e njohurive, ndërsa trajnimi praktik në kompani ndihmon të mësuarit holistik në situata reale dhe e ekspozon nxënësin në mjedis autentik pune.




Figura 1: Elementet e arsimit profesional dhe trajnimit

Sistemi i tillë është veçanërisht efektiv nëse përfshin një qasje gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar që kombinon arsimin, trajnimin dhe masat për punësim, paraqitur në Figurën 2, ndërsa për zbatim të suksesshëm duhet bashkëpunimi i të gjithë palëve të interesuara dhe partneritete midis institucioneve arsimore (shkollat e mesme profesionale) dhe sektorit privat (ndërmarrjet) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.




Figura 2: Lidhja midis kompanive, shkollave profesionale dhe tregut të punës

Përveç gatishmërisë institucionale, kryesisht të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve të tjera arsimore shtetërore që kontribuojnë në këtë fushë, është e nevojshme të kontribuojë sektori privat, përkatësisht përfshirje aktive e kompanive që sigurojnë mësim praktik dhe trajnim të nxënësve dhe përgatitje për punë të ardhshme. Rëndësia e kompanive nuk shihet vetëm në procesin e realizimit të trajnimit praktik të nxënësve, por përfshirja e kompanive fillon që para realizimit të trajnimit praktik. Përkatësisht, bashkëpunimi midis punëdhënësve dhe profesionistëve nga fusha e arsimit, fillon nga vetë përpilimi i programeve arsimore. Kohezioni i tillë i përvojave nga aspekti teorik, metodologjik dhe praktik paraqet bazë solide për zhvillimin e programeve arsimore, të cilat në tërësi do të plotësojnë aspektet sociale dhe teknike të profesionit dhe do të lehtësojnë kalimin drejt tregut të punës.

Por, megjithëse bashkëpunimi me punëdhënësit është rritur vitet e fundit, megjithatë nuk është i mjaftueshëm, nëse flasim për arsimim profesional dhe trajnimin cilësor dhe funksional. Sipas të dhënave⁷, të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim, për vitin shkollor 2019/2020, në arsimin profesional teknik katërvjeçar, në procesin e realizimit të trajnimit praktik, janë përfshirë 887 kompani në të cilat trajnimi praktik realizohet nga 8.876 nxënës nga gjithsej 37.140 nxënës të regjistruar. 28.264 nxënës të tjerë, trajnimin praktik e realizojnë në shkollë, pa pasur mundësi të shkojnë te një punëdhënës.

Në arsimin profesional tre-vjeçar për profesione, në procesin e realizimit të trajnimit praktik, janë përfshirë 453 kompani në të cilat trajnimi praktik realizohet nga 1.856 nxënës nga gjithsej 2.815 nxënës të regjistruar, ndërsa pjesa tjetër trajnimin e realizojnë në shkollë.

Të dhënat nuk na japin imazhin e bukur për të cilin ëndërrojmë. Është më se e qartë se, nëse sektori privat ka nevojë për kuadër profesional dhe të kualifikuar, ai duhet të hap dyert e kompanive dhe t'u mundësojë nxënësve të realizojnë trajnim praktik në mënyrë cilësore.

7 Të dhënat dorëzohen rregullisht në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdo vit

GJETJET E HULUMTIMIT



Në këtë pjesë janë paraqitur gjetjet e fituara përmes analizës së përgjigjeve të pyetësorit të anketës drejtuar kompanive, e cila u realizua në terren. Gjatë hulumtimit, u përfshinë 70 kompani në të gjithë Maqedoninë.

Pyetësori përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë të pyetësorit, të anketuarit që morën pjesë në analizën dhanë informacione të përgjithshme rreth kompanisë së tyre.

I. Informacione të përgjithshme

Nga numri i përgjithshëm i kompanive të përfshira në pyetësorët e anketës, sipas rajoneve planore, 27 kompani ose 38,57% janë nga rajoni i Shkupit; 14 kompani ose 20% nga rajoni i Vardarit dhe po aq nga rajoni i Pellagonisë; 2 kompani ose 2,86% nga rajoni Jugperëndimor dhe po aq kompani nga rajoni Juglindor; 7 kompani ose 10% nga rajoni Lindor; 3 kompani ose 4,29% nga rajoni i Pollogut dhe 1 kompani ose 1,43% nga rajoni Verilindor. Në tabelën nr.1 paraqitet numri i kompanive të përfshira në anketë, sipas rajoneve.

Tabela Nr. 1: Numri i kompanive të përfshira në anketë sipas rajoneve

Rajonet sipas NNjTS	Numri i kompanive	%
Rajoni i Shkupit	27	38,57
Rajoni i Vardarit	14	20,00
Rajoni Jugperëndimor	2	2,86
Rajoni Juglindor	2	2,86
Rajoni Lindor	7	10,00
Rajoni i Pollogut	3	4,29
Rajoni i Pellagonisë	14	20,00
Rajoni Verilindor	1	1,43

Në anketë u përfshinë kompani që i përkisnin 11 sektorëve të kualifikimeve sipas KKK. Nga numri i përgjithshëm i kompanive, 15,71% e kompanive i përkasin sektorit të ekonomisë, drejtësi dhe tregti dhe sektorit të kimisë dhe teknologjisë, 14,29% i përkasin sektorit tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme dhe 12,86% sektorit gjeologji, xehetari dhe metalurgji. Nga kompanitë e tjera, 8,57% i përkasin sektorit të elektroteknikës (TIK) dhe sektori hoteleri dhe turizëm, 7,14% sektorit të ndërtimit dhe gjeodezisë dhe sektorit të shërbimeve personale, 4,29% sektorit makinerisë dhe 2,86% sektorit të bujqësisë, peshkatarisë dhe veterinarisë dhe sektorit komunikacion, transport dhe depozitim. Të dhënat janë paraqitur në Tabelën 2.

Tabela Nr. 2: Numri i kompanive sipas sektorit të kualifikimit të cilit i përkasin

Sektorët e kualifikimeve sipas KKK-së	Numri i kompanive	%
Gjeologji, xehetari dhe metalurgji	9	12,86
Ndërtimtari dhe gjeodezi	5	7,14
Ekonomi, drejtësi dhe tregti	11	15,71
Elektroteknikë (TIK)	6	8,57
Bujqësi, peshkatarri dhe veterinarri	2	2,86
Shërbime personale	5	7,14
Makineri	3	4,29
Komunikacion, transport dhe depozitim	2	2,86
Tekstil, lëkurë dhe prodhime të ngjashme	10	14,29
Hoteleri dhe turizëm	6	8,57
Kimi dhe teknologji	11	15,71

Në anketën morën pjesë kompani që i përkisnin sektorëve të ndryshëm ekonomikë, sipas veprimtarive në KKV. Të dhënat janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela Nr. 3: Numri i kompanive sipas veprimtarisë së tyre sipas KKV

Veprimtaritë sipas KKV-së	Numri i kompanive	%
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	1	1,43
Xehetari dhe gurore	3	4,29
Industria prodhuese	30	42,86
Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	3	4,29
Furnizim me ujë; shkarkimi i ujërave të zeza, menaxhim me mbeturinat dhe veprimtari për rehabilitimin e mjedisit	1	1,43
Ndërtimtari	5	7,14
Tregti me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	3	4,29
Transport dhe depozitim	3	4,29
Informacione dhe komunikime	2	2,86
Objektet e akomodimit dhe veprimtari shërbimi me ushqim	3	4,29
Veprimtari financiare dhe të sigurim	4	5,71
Veprimtari në lidhje me pronën e patundshme	1	1,43
Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	2	2,86
Veprimtari administrative dhe ndihmëse shërbyese	5	7,14
Veprimtari të tjera shërbimi	4	5,71

II. Përfshirja e sektorit privat në arsimin profesional dhe trajnimin dhe bashkëpunimi me shkollat

Në pjesën e dytë të pyetësorit, me titull *Përfshirja e sektorit privat në arsimin profesional dhe trajnimin dhe bashkëpunimi me shkollat*, qëllimi kryesor ishte identifikimi i situatës aktuale në lidhje me zbatimin e trajnimit praktik, interesin e kompanive për përfshirje në arsimin profesional dhe trajnimin dhe mbështetjen që kompanitë e ofrojnë për shkollat (financiare, materiale, etj.), si dhe të sigurohen informacione çfarë do të ndërmarrin kompanitë me nxënësit që kanë realizuar trajnimin praktik tek ata, pas përfundimit të arsimit profesional.

Nga të anketuarit 70 kompani, në pyetjen nëse kompania e tyre ka bashkëpunuar ndonjëherë me shkollë të mesme profesionale, 60% e të anketuarve thanë se nuk kanë bashkëpunuar, ndërsa 40% janë përgjigjur se kanë bashkëpunuar me shkollë profesionale. Të dhënat janë paraqitur në grafikisht në figurën numër 3.




Figura 3: Bashkëpunimi i kompanive me shkollën e mesme profesionale

Megjithëse nevoja për bashkëpunim në arsimin profesional dhe trajnimin është e pashmangshme dhe e domosdoshme për të ngritur nivelin dhe qëndrueshmërinë e cilësisë, veçanërisht në zbatimin e trajnimit praktik, të dhënat tregojnë se ende ekziston bashkëpunim i pamjaftueshëm midis kompanive dhe shkollave profesionale. Kjo situatë tregon që ka nevojë për të ndërmarrë aktivitete të ndryshme për intensifikimin e bashkëpunimit të tillë.

Nisur nga kjo situatë, Oda Ekonomike e Maqedonisë, konsideron se në të ardhmen duhet të jetë iniciator për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave profesionale dhe kompanive, përmes takimeve të shumta të punës, ngjarjeve të përbashkëta për të promovuar bashkëpunimin dhe vizitat e ndërsjella në shkollat profesionale dhe kompanitë. Kjo qasje do të ndihmojë në rrjetëzimin e të gjithë palëve të interesuara, ndërsa do të rezultojë në ide dhe projekte të reja nga të cilat do të përfitojnë të gjithë palët e interesuara, por edhe komuniteti më i gjerë.

Ato kompani që u përgjigjën pozitivisht në pyetjen paraprake, në pyetjen e ardhshme është dashur të japin përgjigje për formën e bashkëpunimit që realizojnë me shkollat profesionale. Sipas të dhënave, nga gjithsej 28 kompani, 19 kompani bashkëpunojnë përmes realizimit të trajnimit praktik të nxënësve në kompani, 7 kompani u përgjigjën se këtë e realizojnë me vizita dhe shikim të kompanisë, nga nxënësit, dhe vetëm 2 kompani u përgjigjën se kanë pajisur punëtori shkollorë. Paraqitje grafike është dhënë në figurën 4.




Figura 4: Forma e bashkëpunimit të realizuar ndërmjet kompanive dhe shkollave profesionale

Nëse shikojmë në mënyrë më sistematike të dhënat se si arrihet bashkëpunimi, vihet re se “trajnimi praktik në kompani” si formë është më i përfaqësuar. Përveç përgjigjeve të ofruara (“trajnim praktik në kompani”, “vizitë dhe shikim të kompanisë” dhe “pajisje e punëtorisë / laboratorit shkollor”) në format të tjera të bashkëpunimit, kompanitë që morën pjesë në anketën, theksuan se bashkëpunimi realizohet përmes ligjëratave dhe moduleve për arsimin e të rriturve, si dhe përmes programeve për rikualifikimin e fuqisë punëtore, që është një shembull pozitiv se kompanitë e përfshira në procesin e arsimit profesional dhe trajnimit, kontribuojnë edhe në arsimin e të rriturve.

Në pyetjen tjetër se sa gjatë realizohet bashkëpunimi me shkollën profesionale, 6 kompani janë përgjigjur se bashkëpunimi është nga 1 në 2 vjet, 12 kompani kanë bashkëpunim nga 3 deri në 5 vjet, ndërsa 10 kompani janë përgjigjur se bashkëpunimi me shkollat profesionale zgjat më shumë se 5 vjet, siç është paraqitur në figurën nr. 5.




Figura 5: Kohëzgjatja e bashkëpunimit të realizuar midis kompanive dhe shkollave profesionale

Të dhënat tregojnë se kompanitë që kanë filluar bashkëpunimin me shkollat profesionale e vazhdojnë këtë bashkëpunim. Ndoshta një bashkëpunim i tillë i kompanive duhet të tregohet si shembull i mirë për të inkurajuar bashkëpunimin me ato kompani që nuk janë përfshirë ende në procesin e arsimit profesional dhe trajnimit.

Në Tabelën 4 janë paraqitur kualifikimet për të cilat nxënësit realizojnë trajnim praktik në kompanitë.

Tabela Nr. 4: Kualifikime për të cilat realizohet trajnim praktik

Sektorët	Kualifikimet dhe profesionet	Sektorët	Kualifikimet dhe profesionet
Gjeologji, xehetari dhe metalurgji	Teknik minierash	Komunikacion, transport dhe depozitim	Teknik i transportit dhe shpedicionit
	Teknik i gjeologjisë		
Ndërtimtari dhe gjeodezi	Teknik i ndërtimit	Tekstil, lëkure dhe prodhime të ngjashme	Konfeksioner
	Kontabilist		Operator për qepje
Ekonomi, drejtësi dhe tregti	Nëpunës zyre	Hoteleri dhe turizëm	Receptionist
	Teknik i drejtësisë		Kamerier
	Elektroteknik – energjeti		Kuzhinier
Elektroteknikë (TIK)	Mekatronik	Kimi dhe teknologji	Teknik i operacionit kimik për gomë
	Elektrik-elektromontues		
	Mekanik		Teknik i ushqimit
Makineri	Teknik i makinerisë		
	Operator i teknologjisë së përpunimit të metaleve me deformim dhe gryerje		
	Operatori i makinës bluarëse universale		
	Operatori i makinave CNC		
	Vegëltar		
	Saldues		

Nga të dhënat e siguruar mund të vërehet se kualifikimet dhe profesionet e përmendura për të cilat realizohet trajnim praktik në kompani, korrespondojnë me profesionet e kërkuara në tregun e punës, të publikuara në analizat zyrtare të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut⁸.

Pas identifikimit të kualifikime për të cilat realizohet trajnim praktik, kompanive u është kërkuar të përgjigjen për numrin e nxënësve, të cilët gjatë vitit shkollor kanë realizuar trajnimin praktik tek ata. Në për-

8 Raporti vjetor për vitin 2019 i Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, skedari: <https://av.gov.mk/content/%D0%94%D0%BE%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B8/%D0%98%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D1%98%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%90%D0%92%D0-A0%D0%A1%D0%9C%202019.pdf>

puthje me rrethanat, 36% e kompanive u përgjigjën se te ata realizojnë trajnim praktik nga 1-6 nxënës, 25% u përgjigjën se realizojnë nga 6 deri në 10 nxënës, 32% e kompanitë nga 11 deri në 20 nxënës, ndërsa përqindja e kompanive ku mbi 20 nxënës realizojnë trajnim praktik është shumë e vogël, përkatësisht 7%. Paraqitje grafike është dhënë në figurën nr. 6.




Figura 6: Numri i nxënësve që realizojnë trajnim praktik në një kompani

Duke pasur parasysh numrin e nxënësve që realizojnë trajnim praktik në kompani gjatë një viti shkollor, ekziston një përqindje e vogël e kompanive që mund të absorbojnë më shumë se 20 nxënës për trajnim praktik gjatë një viti.

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës,⁹ këto të dhëna korrespondojnë me statistikën mbi numrin e subjekteve afariste aktive sipas numrit të të punësuarve, përkatësisht vetëm 0,3% e subjekteve afariste aktive kanë mbi 250 të punësuar. Sipas statistikave, në ekonominë maqedonase pjesën më të madhe ose 80,7% e zënë subjektet afariste me 1-9 të punësuar. Sipas kësaj situatë të tregut, parashihet numër i vogël i kompanive që do të jenë në gjendje të pranojnë më shumë nxënës për trajnim praktik gjatë vitit.

Bazuar në informacionet rreth numrit të nxënësve që realizojnë trajnim praktik në një kompani, pyetja tjetër për të cilën u kërkua përgjigje ishte të shënohet se sa ditë në javë nxënësit realizojnë trajnimin praktik në kompani. Shumica e kompanive deklaruan se nxënësit kanë realizuar trajnim praktik tek ata në kohëzgjatje jo më shumë se 5 (pesë) ditë në një vit shkollor, ndërsa një numër i vogël i kompanive deklaruan se nxënësit kanë realizuar praktikën deri në 30 ditë gjatë një viti shkollor.

Në pyetjen nëse kompania e tyre ka mentor të ngarkuar për kryerjen e trajnimeve praktike, nga gjithsej 28 kompani që janë përgjigjur pozitivisht se realizojnë trajnime praktike të nxënësve, 27 kompani janë deklaruar se kanë angazhuar person / mentor i cili kujdeset për nxënësit dhe monitoron përparimin e tyre, por gjithashtu ka ndjekur trajnim për mentorë, ndërsa 1 kom-

⁹ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbrtxt=79>

pani deklaroi se ka angazhuar person për monitorimin e nxënësve, por nuk ka vizituar trajnimin për mentorë.

Kjo tregon që rritet ndërgjegjësimi i kompanive për respektimin e Standardit për realizimin e trajnimeve praktike të nxënësve te punëdhënësit dhe Standardin për kuadrin profesional dhe personelin tjetër për kryerjen e trajnimeve praktike te punëdhënësit¹⁰, nga njëra anë dhe respektimi i masave të sigurisë në procesin e prodhimit ose në realizimin e shërbimeve të kompanive të shërbimit, nga ana tjetër.

Njëkohësisht, 25 e kompanive, të cilat kanë mentorë të certifikuar, u përgjigjën pozitivisht në pyetjen nëse gjatë realizimit të trajnimit praktik të nxënësve, udhëhiqen nga plani për realizimin e trajnimit praktik dhe programit mësimor. Numri i kompanive që janë përgjigjur se gjatë realizimit të praktikës nuk kanë plan dhe program të përgatitur paraprakisht, sipas të cilit udhëhiqen gjatë trajnimit praktik të nxënësve, është i pa konsiderueshëm.

Kjo tregon që trajnimi për mentorë, në kompanitë është i dobishëm për përgatitjen e programit për trajnim praktik.

Për të marrë përgjigje konkrete nga kompanitë që paraprakisht janë përgjigjur se kanë bashkëpunim me shkollat profesionale dhe janë përfshirë në procesin e realizimit të trajnimit praktik të nxënësve, u shtrua pyetja nëse pas përfundimit të arsimit dhe trajnimit praktik në mjedisin e tyre të punës, kanë punësuar nxënës dhe sa është numri i nxënësve të punësuar. Në këtë drejtim, 23% e kompanive u përgjigjën se kanë punësuar 2 ose 3 nxënës, ndërsa 1 kompani u përgjigj se kanë punësuar 6 nxënës. Pjesa tjetër 50% e kompanive nuk kanë punësuar asnjë nxënës që ka kryer trajnim në mjedisin e tyre të punës. Të dhënat janë paraqitur në mënyrë grafike në figurën nr. 7.




Figura 7: Numri i kompanive që kanë punësuar nxënës, pas përfundimit të arsimit dhe trajnimit praktik në vetë kompaninë

10 Standardet për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve me punëdhënësit dhe Standardi për staf profesional dhe personelin tjetër për kryerjen e trajnimeve praktike te punëdhënësit, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim <http://csoo.edu.mk/pocetna/istrazuvanje/standardi/>

Të dhënat nuk tregojnë anën e ndritshme, duke pasur parasysh se në tregun e punës ka një mospërputhje të ofertës dhe kërkesës për aftësi dhe kualifikime dhe kompanitë vazhdimisht janë në kërkim të kuadrit profesional. Realizimi i trajnimit praktik në nivel real të punës, duhet të jetë mundësi për kompanitë, që të investojnë në potencialin e ardhshëm njerëzor dhe të përgatisin kuadro për nevojat e tyre.

Duke pasur parasysh se për arsim profesional dhe trajnim cilësor, duhet investim financiar, pyetja tjetër i adresohet sigurimit të përgjigjes, nëse kompanitë investojnë në shkolla profesionale përmes stimuljeve financiarë ose ndihmë shtesë materiale për shkollat dhe / ose nxënësit. Sipas të dhënave, shumica e kompanive ose 80%, u përgjigjën se nuk ofrojnë ndihmë financiare, ndërsa 20% u përgjigjën se investojnë burime materiale në punëtori shkollorë ose laboratorë, sigurojnë bursa ose transport dhe ushqim të ngrohtë për nxënësit që realizojnë trajnim praktik në mjedisin e tyre të punës.

Gjetjet nga të dhënat e fituara, rreth numrit të pamjaftueshëm të kompanive që bashkëpunojnë me shkollat, tregojnë se kompanitë nuk e kanë kuptuar plotësisht përfitimin nga realizimi i trajnimit praktik në mjedisin e tyre të punës, si një mundësi për të përgatitur kuadrin e tyre të ardhshëm, në të cilin nuk duhet të investojnë në mënyrë plotësuese pas punësimit të tyre. Nëse rritet ndërgjegjësimi për përfitimet nga bashkëpunimi me shkollat profesionale, mund të pritët të risin edhe investimet dhe stimulimet për nxënësit dhe shkollat profesionale.

Në pyetjen tjetër nëse ekziston mundësi në periudhën e ardhshme, të arrihet një lloj bashkëpunimi me shkollë të mesme profesionale, pas bisedës sonë me kompanitë që nuk kanë bashkëpunuar me shkollat deri më tani, 81% e kompanive u përgjigjën pozitivisht se ata dëshirojnë të bashkëpunojnë me shkollat profesionale. Rezultatet tregohen në mënyrë grafike në figurën nr. 8.




Figura 8: Mundësia për bashkëpunim të kompanive dhe shkollave profesionale

Duke u nisur nga fakti se realizimi i trajnimit praktik në kompani ka implikime fiskale shtesë, nga kompanitë u kërkua të shpjegojnë se çfarë lloj fondesh dhe subvencionimesh u duhen për të intensifikuar bashkëpunimin me shkollat profesionale. Më poshtë, në Tabela 5, janë paraqitur propozimet e kompanive.

Tabela Nr.5: Pasqyrë e fondeve dhe subvencioneve të kërkuara nga kompanitë

Ndihmë financiare për kompanitë	
1.	Subvencione për përpunimin e materialit edukativ për trajnim për siguri gjatë punës dhe vizualizim dhe mësim praktik në lidhje me proceset e krijimit të produkteve nga asortimenti në dispozicion të kompanisë.
2.	Subvencione për materiale edukative dhe mjete
3.	Subvencione për edukimin e stafit
4.	Subvencione për qira, për hapësirë më të mirë për pjesën teorike të trajnimit
5.	Mjete për vegla dhe makina
6.	Pajisje shtesë për trajnimin e nxënësve
7.	Programe të reja për kualifikime përkatëse
8.	Kompensim me parave për mentorin dhe pajisje për trajnim dhe ushtrime
9.	Kompensim me para për stafin profesional që është i angazhuar në përgatitjen e programeve dhe që punon me nxënësit
10.	Kompensim me para për transport dhe ushqim (veçanërisht për nxënësit nga qytetet e tjera)
11.	Kompensim me para për nxënësit për dy vitet e para
12.	Kompensim me para për sigurimin e nxënësve
13.	Lirime tatimore
14.	Lirime doganore
15.	Bursa për nxënës
16.	Udhëtime studimore

Gjatë realizimit të anketës, për pyetjen lidhur me gatishmërinë e kompanive për të investuar një pjesë të fondeve të tyre në sigurimin e personelit të nevojshëm përmes modelit të arsimit dual, nga numri i përgjithshëm i kompanive, 38 kompani janë të interesuara të investojnë fondet e tyre për të siguruar kuadër, ndërsa 32 kompani nuk kanë asnjë interes të investojnë fondet e tyre për të siguruar kuadrin që u nevojitet. Megjithëse numri i kompanive që duan të investojnë në sigurimin e personelit të tyre është më i lartë, megjithatë është akoma i pamjaftueshëm dhe tregon se kompanitë nuk janë të gatshme të investojnë në sigurimin e kuadrit të tyre. Vlen të merret parasysh që këto të dhëna janë për shkak të bashkëpunimit të pamjaftueshëm të kompanive me shkollat profesionale ose mosbesimit në arsimin profesional dhe trajnim për edukimin e stafit profesional. Edhe një konsideratë tjetër që imponohet, ndërsa rezultoni nga vetë pyetja, është mundësia se nuk kanë informacion të mjaftueshëm për procesin e arsimit dual dhe përfitimet e tij. Të dhënat janë paraqitur në figurën nr. 9.




Figura 9: Gatishmëria e kompanive për të investuar në kuadrin e nevojshëm

Gjetjet tregojnë se në këtë drejtim është e nevojshme të zhvillohen ngjarje për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet e arsimit profesional dhe trajnimit dhe zbatimin e trajnimit praktik dhe për të siguruar lehtësime (doganore ose tatimore) për kompanitë që investojnë në kuadrin e tyre.

Në pyetjen e radhës, e cila paraqet vazhdim të pyetjes paraprake, nëse e njohin konceptin e arsimit dual, konfirmohet konstatimi nga pyetja paraprake se kompanitë nuk kanë informacion të mjaftueshëm në lidhje me konceptin e arsimit dual. Nga gjithsej 70 kompani të anketuara, 60% u përgjigjën se nuk kanë informacion të mjaftueshëm, ndërsa 40% e kompanive u përgjigjën pozitivisht, që është paraqitur grafikisht në figurën 10.




Figura 10: Informimi i kompanive për konceptin e arsimit dual

Të dhënat vetëm konfirmojnë përpjekjet që i bëjnë institucionet arsimore përmes Projektit “Arsim për Punësim” dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë, për të ndërmarrë aktivitete që synojnë informimin e kompanive rreth kësaj fushe. Në kuadër të veprimtarive të Odës Ekonomike të Maqedonisë, gjatë vitit 2019 janë realizuar ngjarje informative në odat rajonale, shoqatat dhe asociacionet, si dhe me Këshillin e Investitorëve të Huaj.

Në Tabelën 6 janë sistematizuar përgjigjet e kompanive që u përfshinë në anketë, në pyetjen se për cilat profesione kanë nevojë, ndërsa për të cilat nuk ka personel mjaftueshëm të arsimuar. Mendimet që janë shënuar, përfshijnë kualifikimet që mund të merren përmes programeve që realizohen në arsimin e mesëm profesional, por edhe përmes programeve studimore në arsimin e lartë.

Tabela Nr. 6: Kualifikimet e kërkuara nga kompanitë

Sektorët e kualifikimeve	Kualifikimet	Sektorët e kualifikimeve	Kualifikimet	
Ndërtimtari dhe gjeodezi	Teknik i ndërtimit	Turizëm	Operator turistik	
	Murator		Teknik për manifestime dhe evenimente	
	Furrtar		Operator për turizëm alternativ	
Kimi dhe teknologji	Kasap		Kamerier i hotelarisë	
	Prodhuesi i birrës		Kamerier për shërbimin e verës	
	Teknik kimik		Banakier	
Shërbime personale	Filigranist		Shërbyese	
Ekonomi, drejtësi dhe tregti	Shitës		Profesion xehetari-gjeologji	Teknik i xehetarisë për eksploitim nëntokësor
	Elektromontues			Teknik i xehetarisë për përpunimin e lëndëve të para minerale
Elektroteknik	Elektroinstalues			Tekstil
	Elektricitist	Operator për hekurosje		
	Elektroteknik	Operator për qepje		
	Mekatronik	Operator për lëkurë		
	Teknik i IT-së	Teknik i dizajnit		

Sektorët e kualifikimeve	Kualifikimet
Profesioni elektro - metalurgjik dhe i makinerisë	Vegëltar
	Operator i përpunimit të metaleve
	Saldues
	Mekanik
	Teknik i makinerisë për automjete motorike
	Teknik i makinerisë
	Operator i vinç pirunit
	Elektricitist
	Operator i stabilimenteve energjetike
	Mirëmbajtës i makinave për konfeksion
Bujqësi	Operator i pajisjeve të procesit
	Agronom
	Operator për punë në mulli
Shëndetësia dhe mbrojtja sociale	Agroteknik
	Teknik farmaceutik
Komunikacion, transport dhe depozitim	Teknik fizioterapeut
	Logjistikë

Gjetjet në mënyrë plotësuese konfirmuan rezultatet e siguruara përmes analizës së bërë vitin e kaluar 2019, nga Oda Ekonomike e Maqedonisë, në kuadër të Projektit “Arsim për Punësim”, me titull “Analizë e nevojave të parashikuara për profesione në shtatë sektorët kryesorë të kualifikimeve¹¹” për profesionet e kërkuara.

Kjo tregon që institucionet arsimore duhet të prezantojnë programe të reja për kualifikime të cilat kërkojnë në tregun e punës për të përbushur kërkesat e kompanive.

Përkundër pyetjes paraprake në lidhje me kualifikimet e kërkuara për funksionimin e papenguar të kompanive, në këtë analizë, ishte me interes të veçantë të shqyrtohet se në cilat profesione nuk kanë nevojë për investohet më tej në arsimin e kuadrove për shkak të numrit të madh të punëtorëve në tregun e punës. Përgjigjet e kompanive që dhanë mendimin e tyre për këtë çështje ishin identike. Ndër profesionet e listuara për të cilat ka numër të madh të punëtorëve në tregun e punës dhe për të cilat nuk ka nevojë të investohet, ishin teknikë të ekonomisë dhe drejtësisë dhe ekonomistë dhe avokatë të diplomuar. Ky grup përfshin gjithashtu teknikë të hotelërisë, për të cilët u komentua se nuk kishin njohuri dhe aftësi profesionale as për teknikë të hotelërisë as për teknik të shërbimit. Disa nga kompanitë konsiderojnë se ekziston numër i madh i dizajnuesve të ueb faqeve.

11 Analiza e nevojave të parashikuara profesionale, në shtatë sektorët kryesorë të kualifikimeve www.mchamber.mk/upload1/publications/238_1.pdf

KONKLUSIONE DHE PROPOZIM - MASA

Nga analiza e përgjigjeve të kompanive, mund të nxirret këto



KONKLUSIONE

1. Bashkëpunimi ndërmjet kompanive dhe shkollave është i pamjaftueshëm, përkundër faktit se kompanitë përballen me mungesë të stafit profesional në punën e tyre aktuale. Ky fenomen nuk është karakteristikë vetëm e në një rajoni planor, por ndodh në të gjitha rajonet planore, në të gjithë sektorët sipas KKK-së dhe në të gjitha veprimtaritë ekonomike sipas KKV-së.
2. Forma më e zakonshme të kompanitë që bashkëpunojnë me shkollat profesionale është realizimi i trajnimit praktik në kompani.
3. Kompanitë që kanë filluar bashkëpunimin me shkollat profesionale në procesin e arsimit profesional dhe trajnimit, bashkëpunimin e vazhdojnë edhe më tej.
4. Kualifikimet përtë cilat realizohet trajnim praktik në kompanitë, korrespondojnë me profesionet e kërkuara në tregun e punës, të publikuara në analizat zyrtare të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por jo në tërësi.
5. Zakonisht, kompanitë që pranojnë nxënës për realizimin e trajnimit praktik mund të pranojnë më pak se 20 nxënës.
6. Në shumicën e kompanive në të cilat është realizuar trajnimi praktik, kohëzgjatja e trajnimit praktik nuk ka qenë më shumë se 5 (pesë) ditë në një vit shkollor, ndërsa numri i kompanive në të cilat është realizuar trajnimi praktik deri në 30 ditë në një vit shkollor, është shumë i ulët.
7. Kompanitë që pranojnë studentë për realizimin e trajnimit praktik në shumicën e rasteve kanë angazhuar

person përgjegjës / mentor i cili kujdeset për nxënësit dhe ka ndjekur trajnime për mentor.

8. Kompanitë që kanë mentorë të certifikuar, në shumicën e rasteve udhëhiqen nga plani për realizimin e trajnimit praktik dhe programit mësimor. Numri i kompanive që nuk kanë plan dhe program të përgatitur paraprakisht, gjatë realizimit të trajnimit praktik, është i pa konsiderueshëm.
9. Trajnimi për mentorë në kompanitë, është i dobishëm për mentorët e certifikuar dhe gjen zbatim praktik në realizimin e trajnimit praktik.
10. Një numër i vogël i kompanive punësojnë nxënësit që kanë kryer shkollimin, të cilët kanë përfunduar trajnim praktik tek ata, megjithëse vazhdimisht janë në kërkim të stafit profesional.
11. Shumica e kompanive, ose 80%, nuk ofrojnë ndihmë financiare ose nuk investojnë burime materiale në punëtorë shkollorë ose laboratorë. Ka pak kompani që ofrojnë bursa, transport ose ushqim të ngrohtë për nxënësit që realizojnë trajnime praktike në mjedisin e tyre të punës.
12. Ekziston interes midis kompanive për të filluar bashkëpunimin me shkollat profesionale.
13. Kompanitë në të cilat realizohet trajnimi praktik kërkojnë subvencione nga shteti në formën e lehtësimeve doganave dhe lehtësimeve tatimore, kompensim financiar për punën e nxënësve për dy vitet e para, kompensimin financiar për sigurimin e nxënësve, kompensim financiar për punën e mentorit dhe materiale arsimore dhe trajnim për të punësuarit.

14. Kompanitë nuk janë ende të gatshme të investojnë në sigurimin e stafit të tyre.
15. Edhe pse janë mbajtur një sërë ngjarje promovuese, shumica e kompanive nuk e kuptojnë konceptin e arsimit dual dhe përfitimet nga ai.
16. Mungesa e kualifikimeve ndodh në të gjitha nivelet e KKK-së.
17. Kompanitë konsiderojnë se tregu i punës është i ngarkuar me teknikë ekonomike dhe juridike, ekonomistë dhe avokatë të diplomuar dhe dizajnues të ueb faqeve. Për kualifikimin teknik i hotelierisë dhe shërbimit, konsiderojnë se duhet të hartohen programe të reja: një për teknik hotelier, dhe tjetri për teknik turistik sepse mbajtësit e kualifikimit nuk kanë njohuri dhe aftësi profesionale as për hotelierë, as teknikë turistik.

Nga vërtetimet përfundimtare, rezultuan këto

REKOMANDIME

- ▶ *Vazhdimi i ngjarjeve promovuese për të inkurajuar bashkëpunimin midis kompanive dhe shkollave profesionale përmes:*
 - a. *prezantimit të praktikave të mira nga bashkëpunime të tilla në panel diskutime, konferenca, debate publike, të organizuara nga Oda Ekonomike e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucione të tjera arsimore, organizata;*
 - b. *prezantimi i praktikave të mira në media nga nxënësit që kanë përfunduar trajnim praktik në kompani (përvoja dhe anët e forta). Ky është një lloj promovimi i vetë kompanisë për përkushtimin dhe përgjegjësinë e saj shoqërore;*

- c. prezantimi në media i bashkëpunimit midis kompanive dhe shkollave, veçanërisht për përfitimet nga investimi i kompanisë në shkollë;
- d. prezantimi në media i programeve të reja arsimore për kualifikime;
- e. vizita të përbashkëta të ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe kryetarit të OEM-së, në kompani për prezantimin e përfitimeve nga bashkëpunimi i ndërsjellë;
- f. vizita të menaxhmentit të kompanive në shkollë, të organizuara përmes OEM-së dhe MASH-it, për t'u njohur me kualifikimet që i ofrojnë shkollat;
- g. organizimi i një manifestimi vjetor nga ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryetari i OEM-së, për ndarjen e fletë falënderimeve ose mirënjohje për kompanitë që bashkëpunojnë me shkollë profesionale dhe kompani që ofrojnë bursa për nxënësit dhe punësojnë nxënësit pas përfundimit të arsimit profesional;
- h. ngjarje për të inkurajuar kompanitë të sigurojnë mentorë dhe t'i certifikojnë të njëjtit.
 - ▶ Hartimi i analizave vjetore nga OEM-ja për kualifikimet e kërkuara dhe harmonizimin e kualifikimeve arsimore në përputhje me kërkesat e sektorit privat.
 - ▶ Përfshirja e Odës në krijimin dhe miratimin e politikave në sistemin arsimor, bazuar në analizat për profesionet e kërkuara dhe përvojat dhe informacionet që i siguron aktualisht nga kompanitë.
 - ▶ Fleksibilitet më i madh i institucioneve arsimore për instalimin e programeve arsimore për të fituar kualifikime të nevojshme për produktivitetin e kompanisë.
- ▶ Lehtësimi i procedurave dhe kohëzgjatja për zhvillimin e programeve të reja arsimore.
- ▶ Zhvillimi i standardeve profesionale dhe standardeve të kualifikimit në përputhje me nevojat e komunitetit të biznesit, me pjesëmarrjen e përbashkët të përfaqësuesve të punëdhënësve nga sektor i caktuar i kualifikimeve dhe institucioneve arsimore.
- ▶ Zhvillimi i programeve arsimore të reja ose moderne të programeve arsimore aktuale për pajisje me kualifikime sipas nevojave të sektorit privat.
- ▶ Vendosja e masave stimuluese nga shteti për sektorin privat, i cili është i përfshirë drejtpërdrejt në arsimin profesional dhe trajnimin, dhe bashkëpunon me shkollat profesionale mbi disa baza:
 - a. lirime tatimore për kompanitë që përfshijnë nxënësit për realizimin e trajnimit praktik (përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për tre vjet ndërsa zgjat trajnimi praktik dhe ulja e tatimit personal mbi të gjitha bazat për 5%);
 - b. irim i kompanisë nga pagesa e taksës mbi të ardhurat personale dhe kontributet për mentorin, me qëllim të inkurajohetritja e numrit të mentorëve për trajnime praktike në një kompani;
 - c. kompensim me para, për nxënësit që realizojnë trajnim praktik në kompanitë, për një deri në dy vitet e para;
 - d. kompensim me para për nxënësit që realizojnë trajnim praktik në kompanitë e sigurimeve dhe ekzaminimeve shëndetësore.
- ▶ Vendosja e një sistemi arsimor dual dhe zhvillimi i konceptit të arsimit dual me fokus mbi trajnimin praktik.

Propozim:

- a. Gjatë vitit të parë të arsimit profesional, nxënësit duhet të realizojnë mësim praktik në kompanitë, një ditë në javë;*
- b. gjatë vitit të dytë të arsimit profesional, nxënësit të realizojnë trajnim praktik në kompanitë dy ditë në javë;*
- c. gjatë vitit të tretë të arsimit profesional, nxënësit të realizojnë trajnim praktik në kompanitë tre ditë në javë.*

Në çdo rast, duhet të veprojmë shpejt, sepse sot, me një sistem të tillë, krijojmë kuadro që nuk mund të realizohet në tregun e punës. Për më tepër, humbasim në mënyrë të pakthyeshme nxënësit më të mirë që formojnë në mënyrë plotësuese arsimin e tyre jashtë vendit tonë dhe punëtorët më të mirë, sepse punësuar atje. Në atë mënyrë, mundësojmë që investimet tona në kapitalin njerëzor të bëhen investime në kapitalin njerëzor për vendet e tjera, në kushte kur kompanitë kanë nevojë për staf profesional dhe kompetent.

SHTOJCA 1:

PYETËSOR PËR KOMPANITË

PËRFSHIRJA E SEKTORIT PRIVAT NË ARSIMIN PROFESIONAL DHE TRAJNIMIN DHE BASHKËPUNIMI ME SHKOLLAT

Të dhënat e siguruara, janë konfidenciale dhe do të përdoren ekskluzivisht për analizë statistikore.

Pyetjeve u përgjigjeni: duke shënimin e përgjigjes në rreshtin e dhënë, ose duke shënuar "X" në katrorin përkatës.

I. Të dhënat e identifikimit për ndërmarrjen

1. Emri i ndërmarrjes

2. Komuna

Shifra

3. Rajoni (Shtojca 1)

7. Veprimtaria (shënoni shifrat e duhura nga Klasifikimi Kombëtar i Veprimtarive - KKV rev.2):

Shifra

a) Themelore:

b) Plotësuese/ t:

1

2

II. Pyetje për përfshirjen e sektorit privat në arsimin profesional dhe trajnimin dhe bashkëpunimi me shkollat

1. Vallë ka realizuar ndonjëherë bashkëpunim kompania juaj me shkollë të mesme profesionale?

a) PO

b) JO

2. Nëse ka bashkëpunim, si realizohet:

- a) Trajnim praktik në kompani
- b) Vizitë dhe shikim i kompanisë
- c) Pajisje e punëtorisë /
laboratorit shkollor
- d) Forma të tjera (specifikoni cilat)

3. Nëse në kompaninë Tuaj realizohet trajnim praktik, sa kohë bashkëpunoni me shkollën?

- a) Më pak se 1 viti
- b) 1-2 vjet
- c) 3-5 vjet
- d) Më shumë se 5 vjet

4. Për cilin kualifikim realizohet trajnimi praktik në kompaninë tuaj?**5. A ekziston një plan dhe program sipas të cilit realizohet trajnimi praktik në kompaninë tuaj?**

- a) 1-5 nxënës
- b) 6-10 nxënës
- c) 11-20 nxënës
- d) Më shumë se 20 nxënës

6. Sa ditë në javë nxënësit realizojnë trajnim praktik në kompaninë tuaj?

7. A keni mentor në kompaninë tuaj i cili monitoron realizimin e trajnimit praktik të nxënësve?

8. A ekziston një plan dhe program sipas të cilit realizohet trajnimi praktik në kompaninë tuaj?

PO

JO

9. Sa nxënës janë punësuar në kompaninë tuaj pasi përfundimit të arsimit dhe trajnimit praktik?

10. Në bashkëpunimin e deritanishëm, a keni ofruar ndihmë financiare ose materiale për shkollën dhe / ose nxënësit?

PO

JO

Nëse jeni përgjegjur PO, shënoni çfarë ndihme keni dhënë (p.sh. bursë për nxënësit shpenzime udhëtimi, ushqim të ngrohtë, pajisje):

11. Nëse deri më tani nuk keni bashkëpunuar me ndonjë shkollë profesionale, a ka mundësi të arrini një lloj bashkëpunimi në periudhën në vijim?

a) PO

b) JO

12. A keni nevojë për ndonjë lloj subvencionimi që do të ndihmojë në rritjen e bashkëpunimit midis kompanisë suaj dhe shkollave?

a) PO

b) JO

Nëse përgjigja juaj është PO, ju lutemi shkruani cilat subvencione janë të nevojshme:

13. A jeni të gatshëm të investoni një pjesë të fondeve tuaja në sigurimin e personelit të nevojshëm për ju, përmes modelit të arsimit dual?

a) PO

b) JO

14. A keni informacion të mjaftueshëm në lidhje me modelin e arsimit dual?

a) PO

b) JO

15. Për cilat profesione keni nevojë, ndërkaq për të cilat nuk ka personel të mjaftueshëm, të arsimuar?

16. Për cilat profesione, sipas mendimit tuaj, nuk duhet të arsimohen kadro sepse ka numër të mjaftueshëm në tregun e punës?

Informacione rreth personit që plotëson pyetësonin

Emri dhe mbiemri:

Kontakt telefon:

E-adresa:

Faleminderit për kohën që ndatë, për të plotësuar pyetësonin!